



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2019:289632

Datë: 30.11.2021

Numri i dokumentit: 02451619

P.nr.344/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA NË RAHOVEC/Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Ilir Rashkaj, me procesmbajtësen Albulena Latifi, zyrtare ligjore e kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të pandehurit M. S. nga Rahoveci, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, i pandehur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.1584/2019 të datës 06.12.2019, në shqyrtimin fillestar publik, të mbajtur me datë 11.11.2021, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Nazmi Krasniqi, të pandehurit dhe përfaqësueses së autorizuar të të dëmtuarës, të njëjtën ditë, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 26.11.2021, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri,

M. S., nga i ati H. dhe e ëma K., e lindur K., i lindur me datë ..., në Rahovec, ku dhe tani jeton, Rr. “S. H.” pa nr., me nr. personal ..., ka të kryer shkollën fillore, pensionist, i martuar, i ati i tre (3) fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i padënuar, ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër për ndonjë vepër penale.

ËSHTË FAJTOR

Sepse, nga data e pavërtetuar e gjerë me datë 04.09.2019, në shtëpinë e tij në Rahovec, Rr. “S. H.”, me qëllim të përfitimit pasuror në mënyrë të kundërligjshme, ka shfrytëzuar energjinë elektrike në kundërshtim me neni 61 të Ligjit për energjinë elektrike të Kosovës, në atë mënyrë që nga shikimi i njehsorit është konstatuar se i dyshuari kishte anashkaluar kabllon furnizues në mur, ku kishte kyçur kabllon 3x2.5mm dhe kishte përcjellë në siguries 2SA monofazë ku kishte tension jashtë matjes së njehsorit, ku me këtë veprim energjia elektrike e shpenzuar nuk është regjistruar, me ç’rast të dëmtuarës K. – Divizioni në Gjakovë, i ka shkaktuar dëm në shumën e përgjithshme prej 411,29 €.

- Me këtë ka kryer veprën penale, vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të neneve 4, 6, 7, 17, 38, 39, 40 par. nënpar.1.1, 43, 69, 70, 314 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPK-së, të njëjtit i shqipton:

DËNIMIN ME KUSHT

Me dënim burgimi në kohëzgjatje prej njëqind e njëzet (120) ditëve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afat prej një (1) viti, nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

I akuzuari lirohet nga shpenzimet e procedurës penale për shkak se është shfrytëzues i pensionit.

E dëmtuara K. – Distrikti në Gjakovë, për realizimin e kërkesës pasurore – juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko - civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë - Departamenti i Përgjithshëm, në këtë gjykatë ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr.1584/2019 të datës 06.12.2019, me të cilën e ka akuzuar të pandehurin M. S. nga Rahoveci, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Gjykata, me datë 17.11.2021, ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, me ç ‘rast kanë marrë pjesë: Prokurori i Shtetit Nazmi Krasniqi, i pandehuri M. S. dhe përfaqësuesja e autorizuar e të dëmtuarës K. – Distrikti në Gjakovë, A. M..

Prokurori i shtetit edhe pas leximit dhe analizimit të aktakuzës ka qëndruar në tërësi pranë saj.

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit i ka dhënë mundësinë që ta pranojë ose të mos e pranojë fajësinë, por paraprakisht ia ka tërhequr vërejtjen lidhur me pasojat e pranimin të fajësisë për veprën penale që i ngarkohet.

I pandehuri M. S. ka deklaruar se: e pranon fajësinë, e ndien vetën fajtor për këtë vepër penale për të cilën akuzohet dhe ndien keqardhje për rastin që i ka ndodhur, i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryen vepër tjetër penale, ndërsa borxhin në lartësi prej 411,29 €, e kundërshton pasi që nuk është e vërtet se ai ka shpenzuar energji elektrike në këtë sasi, po ashtu e ka lutur gjykatën që me rastin e caktimit të dënimit të ketë parasysh faktin se është pensionist, i gjendjes së dobët shëndetësore, pasi që është i paralizuar dhe lidhur me këtë gjykatës do ti ofrojë dëshmi të mjekut, andaj e ka lutur gjykatën që me rastin e caktimit të dënimit, ti shqipton një dënim sa më të butë, si dhe ta liron nga kompensimi i shpenzimeve të procedurës penale.

Pasi që i pandehuri e ka pranuar fajësinë, gjykata ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit, sa i përket pranimin të fajësisë nga ana e të pandehurit dhe përfaqësueses së palës së dëmtuar.

Prokurori i Shtetit Nazmi Krasniqi, ka deklaruar se: nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, pasi që i njëjti e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë,

pranimin e fajësisë e bënë me vetëdije dhe vullnet të plotë, si dhe pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Përfaqësuesja e autorizuar e të dëmtuarës, A. M. deklaron se : nuk e kundërshton pranimin e fajësisë dhe parashtron kërkesën pasurore – juridike, në lartësinë e dëmit sikurse thuhet në aktakuzë.

Duke pasur parasysh të gjitha këto që u thanë më lartë, e meqenëse janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore nga neni 248 par. 1 të KPPK-së, gjyqtari i vetëm gjykues ka aprovuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari dhe nuk është lëshuar në procedurën e provave e as në fjalën përfundimtare, por ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv të aktakuzës.

Gjykata, ka gjetur se i pandehuri ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, dhe gjendjen e këtyre faktike e mori në tërësi ashtu si ishte e përcaktuar në aktakuzë dhe në provat të cilat i përmbante aktakuza, e ato janë:

- Procesverbali mbi konstatimin e gjendjes faktike datë 04.09.2019 me nr.2536829;
- Fatura mbi dëmin e shkaktuar DGJHP198749 të datës 06.09.2019;
- Foto dokumentacioni si dhe shkresat tjera që gjenden në lëndë, e që janë prova të mjaftueshme nga të cilat vërtetohet se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Prandaj, në bazë të këtyre provave dhe vet pranimin të fajësisë, gjykata ka ardhur në përfundim se në veprimet e të pandehurit formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të pandehurin ta shpall fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara në nenet 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Gjykata rrethana veçanërisht rënduese nuk ka gjetur, ndërsa prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të të akzuarit, pranimin e fajësisë, pendimin për rastin që ka ndodhur, se është hera e parë që ka rënë në kundërshtim me ligjin, premtimin para gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryen vepra të tjera penale të këtyra apo të ngjashme posaçërisht mori parasysh faktin se është i gjendjes së dobët ekonomike, është shfrytëzues i pensionit si dhe ka probleme shëndetësore.

Andaj, duke i pasur parasysh të lartcekurat, si dhe rrethanat në të cilat i akuzuari e ka kryer veprën penale, gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi me kusht, është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurit dhe është e bindur se me këtë dënim do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit konform nenit 38 të KPRK-së, dhe i njëjti është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari, si dhe konsiston në parandalimin e kryerësve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, rehabilitimin e tyre si dhe të përmbajë personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarës që kërkesën pasurore – juridike ta realizojë në procedurën e rregullt civile bazohet në nenin 463 të KPPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, u mor konform nenit 453 paragrafi 4 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA NË RAHOVEC
- Divizioni Penal -
P.nr.334/2019, datë 26.11.2021

Zyrtarja Ligjore,
Albulena Latifi

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Irir Rashkaj

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit nëpërmjet kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.